

Edukimi për median dhe informimin në arsimin parauniversitar në Shqipëri

(në këndvështrimin e sistemit arsimor)

Astrit Dautaj

Prej mëse një dekade, edukimi për median dhe informimin është shfaqur në arsimin shqiptar në forma e intensitete të ndryshme. Në disa raste është ofruar me pretendimin e një edukimi të rëndësishëm (dhe i tillë është) që duhet të ketë vend të privilegjuar në procesin e mësimdhënies e, në raste të tjera, është ofruar në formën e një materiali konkret mësimor për mësues ose nxënës. Nuk kanë munguar ndërhyrjet e individëve vizionarë që veprojnë në fushën e medias të cilët i janë ofruar sistemit me ide konkrete, ashtu sikurse, herë pas here, janë zhvilluar edhe veprimtari të përbashkëta të institucioneve të ndryshme me ato arsimore të cilat nuk kanë mundur të nxisin e të krijojnë vazhdimësi në këtë fushë. Thjesht, deri para pak vitesh, edukimi për median dhe informimin nuk arriti të bëhej më shumë se shqetësim që herë pas herë i shtohet listës së gjatë të çështjeve që diskutoheshin të rëndësishme për shoqërinë dhe arsimin.

Gjatë kësaj periudhe, përtej marrëdhënieve të edukimit për median me arsimin, dhe paralel e to, ne kemi parë një medie gjithnjë e më protagoniste e përfshirë aktivisht në informimin dhe diskutimin e mjaft çështjeve kundërshtuese të natyrave të ndryshme, ashtu sikurse kemi parë një medie në një dimension negativ, si prodhuese e lajmeve të rreme e për më tepër e lajmeve ose shkrimeve që prodhonin urrejtje. Ndërkohë, roli i saj, veçanërisht i medias elektronike u rrit në përmasa të mëdha, saqë kjo e fundit, e ndihmuar nga larmia e pajisjeve teknologjike u bë i vetmi burim informimi, veçanërisht për të rinjtë, të cilët merrnin për të mirëqenë edhe çdo informacion që vinte prej saj.

Nga ana tjetër, bota e informacionit u pasurua me ngjarje të ndryshme, ide e veprime ekstremiste, dilema e kundërshti të mëdha të cilat, nga njëra anë, tronditën dhe shqetësuan mendjen njerëzore, ndërsa nga ana tjetër e bënë këtë mendje më të etur për të ditur e për të kuptuar më shumë, por edhe më dyshuese ndaj atyre që ofroheshin si të vërteta nga media ose autoritete të ndryshme politike, fetare, etj.

Thjesht, shoqëria kuptoi se për të kuptuar më mirë botën e ofruar nga media dhe për të qenë më e aftë për të marrë vendimet e duhura, ajo duhet të ishte më e arsimuar në fushën e medias dhe të informimit. Kjo kërkonte një marrëdhënie të re ndërmjet edukimit për median dhe informimin dhe vetë arsimit, një marrëdhënie bashkëpunimi që synon në aftësimin e shoqërisë për të përdorur median si mjet fuqizimi të vetes dhe individit.

Kjo marrëdhënie u përshpejtua nga krijimi dhe konsolidimi i botës së komunikimit online, krahas asaj offline, e cila është bërë arena kryesore e veprimtarisë arsimore, veçanërisht në kushtet e veçanta të pandemisë, por që ka paraprirë dhe ka përshpejtuar një realitet që pritet të bëhet sundues në një të ardhme të afërt.

Arsimi shqiptar ka kohë që e sheh edukimin për median dhe informimin si një dimension të ri të formimit të individit, në kuadrin e formimit të tij me kompetencat e kulturës demokratike, madje e sheh këtë si një **detyrim të madh arsimor, moral e ligjor**.

Ishte ky konteksti që bashkoi nismën e Institutit Shqiptar të Medias (ISHM), mbështetjen e MASR dhe përvojën profesionale të ASCAP në një projekt të përbashkët të financuar nga UNESCO, që ka si objektiv parësor trajnimin e mësuesve në fushën e edukimit për median dhe informimin dhe si material bazë trajnimi kurrikulën e Edukimit për median dhe informimin e UNESCO-s.

Kurrikula e EMI-t e ofruar përmes ISHM-së është një kurrikul model, tërësore, që përfshin të gjithë përbërësit e domosdoshëm që e bëjnë një kurrikul jo vetëm të synuar, por edhe të zbatueshme. Kurrikula e EMI-t përkthehet (dhe është planifikuar të bëhet e tillë) lehtësisht në një politikë kombëtare për edukimin për median dhe informimin në dy drejtimet e saj kryesore:

- a. Kjo kurrikul, në mënyrë të veçantë, është hartuar duke pasur në mendje mësuesin dhe me synimin për t'u integruar në sistemin e zyrar të formimit të mësuesit. Mësues të arsimuar në fushën e medias dhe të informimit do të kenë mundësi më të mëdha për të fuqizuar veten dhe nxënësit në përpjekjet e tyre për të mësuar si të mësojnë, të mësojnë në mënyrë të pavarur dhe të mësojnë gjatë gjithë jetës. Në zbatim të këtij projekti, **ASCAP** ka hartuar strategjinë e edukimit për median dhe informimin, në kuadrin e politikës së trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve. Kjo strategji, në fazën e saj të parë, përfshin përgatitjen e moduleve bazuar në botimin e UNESCO-s, trajnimin e mësuesve të shkollave pilot, ndërsa në fazën e dytë përfshin trajnimin e rrjetit profesional të mësuesve të qytetarisë dhe të shkencave shoqërore në arsimin bazë dhe të mesëm.
- b. Në fazën e dytë të zbatimit të saj, ky edukim synon nxënësin, si përfitues i drejtpërdrejtë i procesit të mësimdhënies dhe i të mësuarit që ndodh në klasë. Mësuesi i arsimuar në fushën e EMI-t mundëson një proces të mësuarit cilësor, në përputhje me qëllimin. Për këtë arsye, reforma më e afërt mësimore në fushën e kurrikulës do të përfshijë edukimin për median dhe informimin në *dimensione më të plota, më të larmishme dhe më të gjera*, jo vetëm në lëndën e qytetarisë e të lëndëve shoqërore në përgjithësi, por në të gjithë kurrikulën shkollore, për t'i kthyer njohuritë dhe aftësitë që mundëson ky edukim në armë të rritjes së njohurive dhe aftësive personale, pra të kompetencave për jetën.

Në mbyllje të këtyre rreshtave, gjej rastin të falënderoj ISHM-në, që asnjëherë nuk hoqi dorë nga përpjekja për ta parë edukimin për median dhe informimin pjesë të politikës dhe të praktikës arsimore të qëndrueshme në shkollë.



Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.



The regional program “Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans” is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM .